# DËSHMI ARKIVI

**A-475823**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Konferenca/ McAllister: BE të njohë arritjet e vendeve që ecin përpara me reformat, të mos i jap hapësirë vendeve të treta në rajon |
| ADRESA | `https://tpz.al/konferenca-mcallister-be-te-njohe-arritjet-e-vendeve-qe-ecin-perpara-me-reformat-te-mos-i-jap-hapesire-vendeve-te-treta-ne-rajon-i334056` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 10:09:36 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 10:08:56 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3b8fbb06a0a7921cf21abf8028bf1638f98b8b2f882b6f81cb46372a7ab0430e` |
| TEKSTI | `19464c659bd7670ed876dd72af51ba1de7970727d852a366ffbad7bc86e11a8f` |
| PAMJA | `f5e827986aa0f9f169b7a7d4a76c4ec69e223b971465df62cb384266c725702c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7d7adfc978d4f656712c36340f36ad5e65d794e98c38f5d0f417263fed5bbab1` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `abea285c66b625fda61d55a4ce47e92e047f4e5aa34cb0aedb7a5ee71b2cb2e0` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7d7adfc978d4f656712c36340f36ad5e65d794e98c38f5d0f417263fed5bbab1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET, 28 SEPTEMBER 2026, 12:08

# Konferenca/ McAllister: BE të njohë arritjet e vendeve që ecin përpara me reformat, të mos i jap hapësirë vendeve të treta në rajon

tpz.al TPZ




Kryetari i Komisionit për Punët e Jashtme të Parlamentit Evropian, David McAllister, ka kërkuar që Bashkimi Evropian të njohë arritjet e vendeve kandidate që përmbushin kushtet dhe avancojnë me reformat, duke i kthyer këto rezultate në hapa konkretë drejt anëtarësimit.

Në një videomesazh drejtuar Konferencës Ndërparlamentare “Agjenda strategjike për zgjerimin e BE-së dhe anëtarësimin e Shqipërisë”, McAllister theksoi se procesi i zgjerimit është i rëndësishëm për forcimin e sigurinë dhe stabilitetit afatgjatë të kontinentit.

Sipas tij, BE nuk duhet të lejoje hapësira në rajon që vendet e treta të zgjerojnë ndikimin e tyre negativ”. McAllister tha se përgjegjësia në procesin e integrimit është e dyanshme. Vendet kandidate duhet të vijojnë me reformat, ndërsa Bashkimi Evropian duhet të reagojë ndaj progresit të tyre.

“Në qendër të programit të BE-së është begatia, prosperiteti dhe siguria, dhe zgjerimi ndihmon në forcimin e të tria këtyre shtyllave. Ai afron ekonomitë me njëra-tjetrën, forcon demokracitë dhe ndihmon në një qëndrueshmëri afatgjatë në kontinentin tonë. Sulmi rus në Ukrainë ka theksuar rëndësinë që ka zgjerimi i BE-së. Të lësh rajonin në një pasiguri kaq të gjatë krijon mundësi që edhe palë të treta të zgjerojnë ndikimin e tyre negativ aty.

BE-ja duhet t’i çojë përpara negociatat sa herë përmbushen kushtet dhe vendet që bëjnë reformat duhet të rrisin besimin te BE-ja. BE-ja duhet të mbajë angazhimin që ka ndërmarrë. Përgjegjësia është dypalëshe: vendet duhet të ecin përpara me reformat dhe BE-ja duhet t’i njohë arritjet dhe t’i kthejë ato në hapa të mëtejshëm për anëtarësimin”, tha ai.

Duke iu referuar Shqipërisë, McAllister vlerësoi hapjen e të gjitha grupkapitujve të negociatave, duke e cilësuar këtë si rezultat të një pune të rëndësishme. Megjithatë, ai nënvizoi se procesi kërkon vijimin e reformave, veçanërisht në forcimin e pavarësisë së gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit dhe funksionimin e institucioneve publike.

ide!
Ish-shefja e SHISH, nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj
Nga Lorenc Vangjeli
Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalitet
Nga Mero Baze

Tej e Këtej
Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!
Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.
Messenger

Moti
Tirana, Albania

WebTV

Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super

korrupsionit dhe funksionimin e institucioneve publike.

imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tjera video

Parlamenti Evropian, tha ai, do të vijojë të mbështesë Shqipërinë dhe Malin e Zi në rrugëtimin e tyre drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

"Shqipëria ka hapur të gjitha grupkapitujt dhe këto arritje pasqyrojnë një punë shumë të madhe të bërë nga qeveria dhe shumë prej nesh që jemi të angazhuar për ta parë të ardhmen e Shqipërisë në BE. Kjo punë i duhet njohur Shqipërisë. Tashmë sfida që qëndron është forcimi i pavarësisë së gjyqësorit dhe arritja e rezultateve të qëndrueshme në luftën kundër korrupsionit, si dhe të sigurohemi që institucionet publike t'u shërbejnë mirë qytetarëve të vet. Ju nxis që këto reforma t'i ndiqni me po atë vendosmëri. Parlamenti Evropian do të vijojë të mbështesë Shqipërinë dhe Malin e Zi në rrugëtimin e tyre drejt anëtarësimit", tha ai.

McAllister: Shqipëria dhe Mali i Zi kanë bërë shumë progres. Presidenti i Unionit përmendi prosperitetin, pra begatinë, sigurinë dhe demokracinë dhe i vendosi në qendër të programit të BE-së dhe zgjerimi kontribuon në të treja këto elemente, të treja këto shtylla, i afron ekonomitë me njëra-tjetrën, i forcon institucionet demokratike dhe ndihmon që të kemi qëndrueshmëri afatgjatë në kontinentin tonë. Sulmi i Rusisë ndaj Ukrainës e ka përforcuar se sa rëndësi ka zgjerimi i BE-së dhe të lësh Ballkanin Perëndimor në një pasiguri kaq të gjatë, me mbështetje të vogël për reformat dhe në këtë situatë kjo krijon mundësi që edhe palët e treta të zgjerojnë ndikimin e vet negativ aty.

Bashkimi Evropian duhet t'i çojë përpara negociatat. Sa herë përmbushen kushtet, vendet që bëjnë reforma do ta kenë mundësinë që të kenë besim tek BE-ja, që BE ta mbajë angazhimin që ka ndërmarrë. Shqipëria i ka hapur të gjithë grupkapitujt, të gjashtë grupkapitujt e negociatave. Në maj ka kapur ato standardet e ndërmjetme. Në korrik i ka mbyllur tre kapituj në lidhje me shkencën, studimet, edukimin dhe kulturën dhe me marrëdhëniet me jashtë. Këto arritje pasqyrojnë një punë shumë të madhe të bërë nga qeveria, nga deputetët dhe nga shumë prej nesh që janë të angazhuar për ta parë të ardhmen e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. I duhet njohur kjo gjë Shqipërisë, i duhet vlerësuar. Detyra tani është që të fuqizohet pavarësia gjyqësore, të kemi më shumë rezultate ndaj korrupsionit dhe të sigurohemi që institucionet publike t'i shërbejnë mirë qytetarëve të vetë. Ju nxis që këto reforma t'i ndiqni me po atë vendosmëri.

Mali i Zi është vendi që ka ecur mjaft përpara në procesin e anëtarësimit. I ka hapur të tre të 33 kapitujt dhe ka mbyllur përkohësisht 18 prej tyre. Dhe duke e përfunduar ky proces, çohet një sinjal shumë i fortë në Ballkanin Perëndimor, sinjal që tregon që anëtarësia në BE është e arritshme. Axhenda e këtij programi në Tiranë i jep vëmendje shumë të posaçme rolit të kuvendeve, sepse si deputetë ne miratojmë legjislacionin e nevojshëm për anëtarësi. Ne i kërkojmë llogari qeverive dhe sigurohemi që angazhimet të zbatohen. Ne gjithashtu shqetësimet e qytetarëve i bëjmë pjesë të këtij procesi"

AKTUALITET / 28 September 2026, 12:02

## "Nuk e lë dot të presë shumë gjatë"/ Rama ndërpret fjalën e eurodeputetit: Më fal që po iki, kam një takim me gjermanët!

AKTUALITET / 28 September 2026, 11:55

## VIDEO/ Mashtruan 64-vjeçarin në Tiranë me kredencialet e një të njohuri të tij, kapen në flagrancë 2 autorët, po merrnin 100 000 euro

AKTUALITET / 28 September 2026, 11:48

## Ekzekutimi i Egli Progës, shtyhet seanca, të akuzuarit kërkojnë gjykim të shkurtuar

AKTUALITET / 28 September 2026, 11:43

## 'Preket' edhe diplomacia/ Grupi i hakerave iranian publikon mbi 600 numra telefonash, pretendon se janë të personelit të SHISH

AKTUALITET / 28 September 2026, 11:34

## Vlerësimi/ Integrimi në BE, raportuesi Schieder: Shqipëria është pararendësja e procesit të zgjerimit! E meriton të jetë anëtare e re brenda dekadës

AKTUALITET / 28 September 2026, 11:29

## Zjarret/ Flakët dalin jashtë kontrollit në një grumbull mbetjesh në Lezhë, rrezikohen banesat

AKTUALITET / 28 September 2026, 11:23

## Rama për zgjerimin e BE: Fëmijët e Ursulës u rritën rreth tavolinës. Mos i lini vendet kandidate të luajnë me 'gangsterin rus' dhe 'lodrat kineze'

AKTUALITET / 28 September 2026, 11:16

## Prezantohet me 6 tetor/ BE harton plan veprimi për kandidatët premtues, mes tyre dhe Shqipëria

AKTUALITET / 28 September 2026, 11:09

## "Jeni argëtuar mjaft me flamingot"/ Konferenca Ndërparlamentare, Rama: E dashurojmë BE, shpresojmë që mos të na lini në baltë!

AKTUALITET / 28 September 2026, 11:00

## VIDEO/ "Nuk kam besim te përkthyesit", Rama, batuta në Konferencën Ndërparlamentare, detaje edhe nga mbledhja e Këshillit

të Sigurisë

AKTUALITET / 28 September 2026, 10:53

Detaje/ Operacioni antidrogë pranë shkollave të Tiranës: Shpërndarësit vepronin në 8 grupe në zona të ndryshme, goditen 5 furnitorë

AKTUALITET / 28 September 2026, 10:46

Bojkoti/ "Partizani", GJKKO shtyn gjyqin ndaj Berishës dhe të pandehurve të tjerë

AKTUALITET / 28 September 2026, 10:39

Arrestimi i Vlora Hysenit/ Mbyllet mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, diskutoi për situatën në SHISH

AKTUALITET / 28 September 2026, 10:31

Pagat/ Drejtësia refuzoi tryezën e Ramës, Kryeministria: Të hapur për dialog! Nga nesër, nis hartimi i skemës së re

AKTUALITET / 28 September 2026, 10:25

"Bëni kujdes"/ Autoriteti për Sigurinë Kibernetike, alarmi për WhatsApp: Po komprometohen llogaritë në rajon, ja si të mbroheni

AKTUALITET / 28 September 2026, 10:19

Ankimimi/ I dënuar me burgim të përjetshëm, Laert Haxhiu kërkesë në Kushtetuese për rigjykim të çështjes! Pretendon shkelje të të drejtave dhe lirive themelore

AKTUALITET / 28 September 2026, 10:13

**Krujë/ Operacion antidrogë, 4 furgona policie zbarkojnë në male, u bashkohen dhe efektivët e Tiranës**

AKTUALITET / 28 September 2026, 10:05

**Bllokimi/ Nis bojkoti edhe për masat e sigurisë në GJKKO, avokatët kundërshtojnë rregulloren: Na cenon punën dhe na diskriminon**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.